



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike
Mbledhja nr. 07
Prishtinë, më 16 shkurt 2010, në orën 10: 00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

I Mbledhjes së Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike

Në mbledhje morën pjesë: Haki Shatri, Safete Hadergjonaj, Kosara Nikoliq, Gani Koci, Arsim Rexhepi, Riza Smaka dhe Synavere Rysha.

Munguan: Anita Morina – Saraçi dhe Enis Kervan.

Të pranishëm: Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit, Fatime Qorri - zyrtare ligjore, KIPRED (staf mbështetës), Artan Venhari dhe Qemajl Marmullakaj, Lage Olofsson - auditor i përgjithshëm, OSBE - Lejla Selimi dhe NDI - Rinor Beka.

Mbledhjen e kryesoi Haki Shatri - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky
Rend i ditës:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 08. 02. 2010,**
3. **Shqyrtimi i Propozimplanit të punës së Komisionit për vitin 2010;**
4. **Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Gani Koci – Pati vërejtjen që komisioni mban mbledhje me një pikë të rendit të ditës. Brenda muajit është paraparë që komisioni të mbaj dy e më shumë mbledhje. Duke pasur parasysh angazhimin e të gjithë anëtarëve të këtij komisioni, propozoi që brenda muajit të shqyrtohen dy ose tri çështje, e jo të mbahen shumë mbledhje dhe aktiviteti i komisionit të vlerësohet në bazë të numrit të mbledhjeve të mbajtura. Ai tha se kjo kërkesë nuk ka të bëjë me mbledhjen e sotme, sepse pika e sotme e rendit të ditës ka shumë rëndësi.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 08.02. 2010

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 08 shkurt 2010, me vërejtjet e deputetëve: Synavere Rysha dhe Riza Smaka.

3. Shqyrtimi i Propozimplanit të punës së Komisionit për vitin 2010

Haki Shatri – Tha se Propozimplanit i punës së Komisionit ju është shpërndarë me rendin e ditës. Propozoi që anëtarët e Komisionit të japin vërejtjet dhe sugjerimet e tyre lidhur me këtë çështje. Planit mund të pësojë ndryshime gjatë vitit, varësisht nga çështjet e proceduara në Komision. Duhet të kemi parasysh se puna e Komisionit është shumë e lidhur me punën e auditorit të përgjithshëm. Hap diskutimin.

Gani Koci – Në qoftë se nisemi nga dy çështje të përgjegjësive të këtij komisioni, që janë dhe do të jenë pjesë e rregullores së punës, nga ajo që ky komision shqyrton raportet e audituara financiare dhe të performancës të të gjitha institucioneve buxhetore në Kosovë, e gjithë puna e këtij komisioni varet nga plani i punës së ZAP- it. Mirëpo, kjo nuk do të thotë që Komisioni nuk ka edhe çështje të tjera, të cilat duhet të definohen se kur dhe në cilën periudhë mund të marrë aktivitetet. Nuk duhet të lidhemi me tre ose katër institucione si: KRPP, APP etj., por të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me ZAP - të gjitha institucionet të kenë një emërtim të përbashkët. Sipas Propozimplanit në muajin mars është paraparë shqyrtimi i deklaratave vjetore financiare të buxhetit të konsoliduar të Kosovës. Nuk kemi deklarata vjetore, kemi raporte vjetore financiare, raporte periodike dhe raporte vjetore të audituara të shpenzimeve financiare. Të jemi të saktë në shprehjet dhe fjalët që përdorim dhe objektivat që i shtrojmë vetvetes. Përgjegjësia dhe kompetenca e këtij komisioni përfshihet si vijon: *të gjitha raportet e audituara financiare dhe të performancës dhe lidhja e drejtpërdrejtë me ZAP*. Komisionit nuk i mohohet e drejta të shikojë edhe raportet e KRPP - së dhe raportet e agjencive të tjera dhe në bazë të tyre të kërkojë dhe të iniciojë çështje, por jo të jetë detyrë primare. Nuk mundemi që në kuadër të kompetencës së Komisionit të themi “*Komisioni shqyrton raportin KRPP- së*”, sepse atëherë duhet të përfshijmë edhe Ministrinë e Financave edhe agjencitë e tjera. Përderisa ekziston Ligji për prokurim publik, Ligji për KRPP etj., këto institucione nuk do të na përgjigjen, sepse raportet do t’ia dërgojnë Kuvendit, Kryesisë, pastaj Kryesia e procedon te organi tjetër. Ne nuk duhet t’i japim kompetencë vetvetes me këtë plan. Te çështja e bashkëpunimit të Komisionit me organizatat është përmendur edhe bashkëpunimi me Ambasadën e Britanisë. Ne bashkëpunojmë me të gjitha ambasadat dhe e çmojmë kontributin e dhënë këtij komisioni, por jo në mënyrë të veçantë vetëm me një institucion ndërkombëtar.

Haki Shatri – Sa i përket kompetencës së Komisionit tha se kemi vështirësi. Është marrë një vendim që kompetencat e asnjë komisioni të mos përfshihen në Rregulloren e re të punës. Përmbajtja që ka mbetur është shumë më ekstreme se ajo që ne e kemi propozuar si Komision. Në planin e punës duhet të parashohim edhe monitorimin e ligjeve, pastaj amandamentimin e ligjeve që kanë të bëjnë me fushëveprimtarinë e këtij komisioni.

Safete Hadergjonaj – Tha se disa herë është debatuar për detyrat dhe kompetencat e këtij komisioni. Personat të cilët i kanë paraparë kompetencat e këtij komisioni nuk i kanë ditur mirë ato. Ne shumë vonë kemi filluar me shqyrtimin e raporteve të auditorit. Domethënë ka qenë viti i kaluar kur ne kemi marrë zyrtarisht raport në kohën e caktuar për shqyrtim. Sikur zyra e auditorit të jetë shumë efektive në punën e saj, ne na dalin mjaft raporte në bazë të të cilave ne në një formë bëjmë monitorimin e Qeverisë. Nuk mund ta bëjmë monitorimin e Qeverisë përmes raporteve financiare që na vijnë, sepse përmes tyre shohim vetëm mënyrën se si kanë ndodhur disa shpenzime, por auditimi është ai i cili shpjegon mënyrën se si janë shpenzuar, si ka rrjedhur mënyra e punësimit, se si ka rrjedhur çështja e prokurimit. Nëse ne nuk do të kemi raporte të auditimit si duhet, ky komision nuk do të jetë funksional. Detyra jonë është monitorimi - duke pasur dokument. Dokumentet mund t’i kemi vetëm prej zyrës së auditimit. Ne do të kemi edhe

raport të auditimit të KRPP- së, të Gjykatës Kushtetuese, të Zyrës së Rregullatorit dhe të agjencive të tjera.

Riza Smaka - Tha se nuk duhet a priori të autolimitohemi. Ky është Komision kompetent funksional i Kuvendit të Republikës së Kosovës për mbikëqyrjen e parasë publike. Si të tillë ne kemi detyrime. Në plan të punës duhet të parashohim një definim p.sh.: *“Komisioni për Mbikëqyrjen e financave publike sipas vlerësimit diskrecional konkludon dhe kërkon raport, informatë, shpjegim..., shembull - sa para paguan Qeveria e Republikës së Kosovës për qiratë në objektet private. Ato objekte janë ndërtim legal apo ilegal? Organet publike qeveritare a mund të ushtrojnë aktivitet në objekte private?”* Për këto objekte Qeveria paguan qira 10 fish mbi standardin. Në qoftë se e marrim një metër katror përfaqësisht 5 euro, atje del se paguajnë 50 euro. Ne duhet të kërkojmë nga auditori që t’i auditojë këto çështje. Fjala e Komisionit është fjala e Kuvendit dhe institucioni që nuk do të na përgjigjej duke u thirrur në disa formalitete, do të ishte a priori i gjykuar negativisht nga opinioni, sepse i fsheh ato të dhëna që janë për të diskredituese ose diskualifikuese.

Haki Shatri – Propozoi që në fund të tekstit të shtohet një pasus, sipas të cilit Komisioni do të mund të ndërmerre iniciativë për çështje të caktuara e që janë nga fushëveprimtaria e tij. Në pikën 6 të theksohet që *“Komisioni do të bashkëpunojë me organizata relevante ndërkombëtare, të cilat e mbështesin drejtpërdrejt atë”*. Po ashtu propozoi që në fund të tekstit të shtohet një pikë *“Komisionin me fillimin e punës së tij për ndërtimin e kapaciteteve e mbështetë Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar përmes KIPRED- it dhe formave të tjera. Komisioni do të bashkëpunojë me të gjithë ata që e mbështesin punën e tij”*.

Riza Smaka – Ne jemi popull mirënjohës dhe duhet ta kultivojmë këtë mirënjohje. Nuk është çështje formale, është çështje materiale, emocionale dhe politike. Në pikën ku flitet për agjendën dhe vizitën studimore në Mbretërinë e Bashkuar, ne me *“fusnotë”* mund të theksojmë se kush e ka financuar Komisionin dhe t’i shprehim mirënjohje. Në mënyrë të njëjtë mund të veprojmë me të gjitha rastet e tjera.

Haki Shatri – I njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur me mundësinë e një vizite në Slloveni. Vizita është paraparë në fund të muajit mars. Kjo është e rëndësishme për përfshirje në planin punës.

Gani Koci- Lidhur me vizitat e Komisionit, propozoi që të ketë një koordinim në mes të komisioneve, sepse edhe Komisioni për buxhet dhe financa ka planifikuar vizitë në Holandë dhe Gjermani gjatë muajve mars dhe prill.

Haki Shatri – Tha se vizitat e Komisionit do të realizohen duke mos e penguar punën e komisioneve të tjera.

Synavere Rysha – Lidhur me Propozimplanin e punës së Komisionit, tha se në muajin mars është paraparë shqyrtimi i raportit të auditimit të brendshëm për vitin 2009. Auditimi asnjëherë nuk mund të fillojë në muajin mars, sepse pasqyrat financiare nuk mbyllen deri në atë kohë. Përderisa këto pasqyra nuk mbyllen, atëherë auditori e ka vështirë që të konstatojë, sepse ata mund të fshehin pasqyrat duke u thirrur pikërisht në këtë se nuk janë mbyllur ende pasqyrat financiare. Kur të mbyllet viti fiskal, auditori mund të auditojë për vitin 2009.

Haki Shatri – Propozoi që pika dy e paraparë në muajin mars të zhvendoset në muajin prill, ndërsa pika tre të zhvendoset në muajin maj. Po ashtu propozoi që Komisioni të merret edhe me mbikëqyrjen e shpenzimeve të organizatave të pavarura, buxhetin e të cilave e lejon drejtpërdrejt Kuvendi.

Lage Olofsson - auditor i përgjithshëm – I njoftoi anëtarët e Komisionit se raporti që do të procedohet Komisionit në muajin mars është një raport i përgjithësuar për gjithë komunat e Kosovës, por ky raport është raport i auditimit të komunave për vitin 2008. Njoftoi anëtarët e Komisionit se ZAP ka filluar me auditimin e 5 komunave për vitin 2009. Raportet për komunat për vitin 2009 do të raportohen në qershor të vitit 2010. Dhe atëherë do të përfshihet si raport i përgjithshëm edhe në raportin vjetor të auditimit.

Gani Koci – Lidhur me çështjen e raportimit tha se atë e përcakton Ligji. Çështjet e auditimit janë çështje ligjore dhe janë afatet ligjore se kur bëhen ato. Puna e Komisionit është e lidhur me ZAP, prandaj datat e raportimeve duhet të harmonizohen. Për çështje të ngutshme mund të lëmë hapësirë në plan të punës për të trajtuar ato.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e financave publike, njëzëri e nxori këtë

PËRFUNDIM

- *Miratohet Plani i punës së Komisionit për vitin 2010, me propozimet - plotësimet e anëtarëve të Komisionit.*
- *Plani i punës mund të pësojë ndryshime – të plotësohet varësisht nga çështjet që mund të vijnë e që kanë të bëjnë me fushën e veprimtë të këtij komisioni.*

Mbledhja përfundoi në orën 11:00

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Haki Shatri